



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:032233
Datë: 29.09.2021
Numri i dokumentit: 02223699

C.nr. 1005/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Civil, me gjyqtarin Alajdin Tërshnjaku, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. B. D., nga Prishtina, Sh. K., nga Prishtina, Z. L., nga Prishtina, Xh. S., nga Rahoveci dhe V. I., nga Fushë Kosova të cilët me autorizim i përfaqëson Avokate Ardita Morina me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), për shkak të padisë për kompensimin e shujtave dhe shpërblimit jubilar, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, me date 13.09.2021 (hartuar më 28.09.2021), mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. B. D., nga Prishtina, Sh. K., nga Prishtina, Z. L., nga Prishtina, Xh. S., nga Rahoveci dhe V. I., nga Fushë Kosova.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), që paditësve t'ia paguaj shumat si në vijim:

I.A. B. D., në emër të kompensimit për ushqim (shujtave ditore) për 745 ditë të prezencës në punë, prej datës 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 shumën 1,490.00€, si dhe në emër të kompensimit të pagesës jubilarë, për 13 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të një page bazë, shumën 229.00€ apo në tërësi shumën e përgjithshme 1,719.00€ të gjitha këto shuma me kamatëvonesë në lartësi 8% e cila do të llogaritet nga data e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

2.Sh. K. Gj., në emër të kompensimit për ushqim (shujtave ditore) për 887 ditë të prezencës në punë, prej datës 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 shumën 1,774.00€, si dhe në emër të kompensimit të pagesës jubilarë, për 13 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të një page bazë, shumën 229.00€ apo në tërësi shumën e përgjithshme 2003.00€ të

gjitha këto shuma me kamatëvonesë në lartësi 8% e cila do të llogaritet nga data e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

3.Z. L., në emër të kompensimit për ushqim (shujtave ditore) për 831 ditë të prezencës në punë, prej datës 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 shumën 1.662.00€, si dhe në emër të kompensimit të pagesës jubilarë, për 19 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të një page bazë, shumën 229.00€ apo në tërësi shumën e përgjithshme 1.891.00€ të gjitha këto shuma me kamatëvonesë në lartësi 8% e cila do të llogaritet nga data e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

4.Xh. S., në emër të kompensimit për ushqim (shujtave ditore) për 892 ditë të prezencës në punë, prej datës 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 shumën 1,784.00€, si dhe në emër të kompensimit të pagesës jubilarë, për 19 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të një page bazë, shumën 229.00€ apo në tërësi shumën e përgjithshme 2,013.00€ të gjitha këto shuma me kamatëvonesë në lartësi 8% e cila do të llogaritet nga data e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

5.V. H. I., në emër të kompensimit për ushqim (shujtave ditore) për 892 ditë të prezencës në punë, prej datës 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 shumën 1.784.00€, si dhe në emër të kompensimit të pagesës jubilarë, për 14 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të një page bazë, shumën 229.00€ apo në tërësi shumën e përgjithshme 2,013.00€ të gjitha këto shuma me kamatëvonesë në lartësi 8% e cila do të llogaritet nga data e marrjes se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

III. OBLIGOHET e paditura që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme 1,049.00€.

A r s y e t i m

Pretendimet e Paditësve-

Paditësit përmes padisë së parashtruar kësaj gjykate si dhe përmes përfaqësueses të autorizuar, në bazë të parashtrësës për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv të dorëzuar në seancën përgatitore si dhe nga deklaratimet e dhëna në shqyrtimin gjyqësor, kanë kërkuar realizimin e shpërblimit jubilar dhe të shujtave ditore nga e paditura sipas Ligjit të punës - Neni 90 lidhur me Kontratën Kolektive Sektoriale të Arsimit të Kosovës (KKSAK) – Neni 35 par. 7 dhe 8, të njëjtit kanë deklaruar se janë të punësuar në institucionin arsimor SHME “Gjin Gazulli” në Prishtinë me kontratë pune në afat të pacaktuar.

Meqë e paditura është nënshkruese e KKSAK-së dhe ka pasur për obligim përmbushjen e detyrimeve të kërkuara si me këtë padi, pasi që paditësja ka parashtruar kërkesë, e paditura është përgjigjur se nuk ka buxhet të planifikuar dhe aktiv për përmbushjen e një kërkesë të tillë.

Gjykata pas dorëzimit të parashtrës për zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv dhe zgjerimin të saj në aspektin objektiv nga i autorizuarit të paditëseve, në seancën përgatitore, me aktvendim miraton kërkesën e palëve paditëse për rregullimin e padisë si në aspektin subjektiv po ashtu edhe në aspektin objektiv.

Meqenëse obligimi i të paditurës mbetet edhe me tutje i porealizuar ndaj paditëseve, i autorizuari i tyre i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pretendimet e Palës së Paditur.-

E paditura në përgjigjen në padi të datës 27.04.2021, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të paditësve si të pabazuar për arsye se sipas kontratës kolektive të arsimit të datës 18.04.2017, nuk janë parapare dhe nuk janë ndare mjete për realizimin e këtyre obligimeve dhe ne rast të realizimit të pagave jubilarë dhe përcjellëse, Komuna e Prishtinës rrezikon planifikimin buxhetor. Bazuar në këto fakte përfaqësuesi i Komunës së Prishtinës kërkon të refuzohet në tërësi kërkesë padia e paditësit si e pa bazuar.

Administrimi i Provave.-

Më qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datën 13.09.2021, gjykata bëri administrimin e provave të paditësve për secilin veç e veç, e si më të rëndësishmet nxori:

1) Për paditësen A. B. D.

- Kontrata e punës me nr.231 e datës 01.12.2007,
- Vërtetimi për përvojën e punës i datës 12.02.2020,
- Vërtetimi mbi ditët e prezencës në pune i datës 09.09.2021.

2) Për paditësen Sh. K. Gj.

- Kontrata e punës me nr.224 e datës 01.10.2007,
- Vërtetimi për përvojën e punës i datës 12.02.2020,
- Vërtetimi mbi ditët e prezencës në pune i datës 09.09.2021.

3) Për paditësen Z. L.

- Kontrata e punës me nr.146 e datës 01.09.2001,
- Vërtetimi për përvojën e punës i datës 12.02.2020,
- Vërtetimi mbi ditët e prezencës në pune i datës 09.09.2021.

4) Për paditësin Xh. S.

- Kontrata e punës me nr.135 e datës 19.02.2001,
- Vërtetimi për përvojën e punës i datës 12.02.2020,
- Vërtetimi mbi ditët e prezencës në pune i datës 09.09.2021.

5) Për paditësen V. H. I.

- Kontrata e punës me nr.246 e datës 08.09.2008,
- Vërtetimi për përvojën e punës i datës 12.02.2020,
- Vërtetimi mbi ditët e prezencës në pune i datës 09.09.2021

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veq e veq dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimet e Gjykatës.-

Nuk është kontestuese se paditësit A. B. D., Sh. K., Z. L., Xh. S., dhe V. I., janë të punësuar tek e paditura, institucionin arsimor SHME "Gjin Gazulli" në Prishtinë me kontratë pune – ku vazhdojnë të punojnë edhe më tutje. Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte baza ligjore e kërkesëpadisë për faktin se ligji nuk e parasheh shprehimisht një kompensim si në kërkesën e paditëseve, dhe se rrjedhimisht e paditura nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për kompensim të tillë.

Paditësit duke konsideruar se i takon e drejta në kompensimin e shujtave ditore dhe pagës jubilarë për vitet e përvojës në pune, në bazë të KKSAK-së, pasi që e paditura nuk e ka kompensuar, i është drejtuar gjykatës me padi për realizimin e të drejtave të tyre.

Në bazë të KKSAK-së, e cila ka hyrë në fuqi në dt. 18 .04.2017, në nenin 35 par. 7 të saj është paraparë që të punësuarve t'iu sigurohet kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë dhe atë nga 2.00€ euro për një ditë pune.

-Nga Kontrata e punës me numër 231 e datës 01.12.2007, gjykata ka vërtetuar se paditësja A. B. D., ka përvoja pune mbi 13 vite dhe të njëjtës i takon 50% e një page bazë dhe atë nga paga bazë në shumën 459.00 euro paditëse i takon shuma 229.00 euro për shpërblimit jubilar, ndërsa në bazë të vërtetimit të datës 12.02.2020 të administruar si provë, gjykata vërteton se për periudhën kontestuese 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 paditësja ka shërbyer për 745 ditë pune për të cilat e paditura nuk ia ka paguar shujtën ditore 2 euro në ditë apo shumën në lartësi 1,490.00€.

-Nga Kontrata e punës me numër 224 e datës 01.10.2007, gjykata ka vërtetuar se paditësja Sh. K. Gj., ka përvoja pune mbi 13 vite dhe të njëjtës i takon 50% e një page bazë dhe atë nga paga bazë në shumën 459.00 euro paditëse i takon shuma 229.00 euro për shpërblimit jubilar, ndërsa në bazë të vërtetimit të datës 12.02.2020 të administruar si provë, gjykata vërteton se për periudhën kontestuese 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 paditësja ka shërbyer për 887 ditë pune për të cilat e paditura nuk ia ka paguar shujtën ditore 2 euro në ditë apo shumën në lartësi 1,774.00€.

-Nga Kontrata e punës me numër 146 e datës 01.09.2001, gjykata ka vërtetuar se paditësja Z. L., ka përvoja pune mbi 19 vite dhe të njëjtës i takon 50% e një page bazë dhe atë nga paga bazë në shumën 459.00 euro, paditëse i takon shuma 229.00 euro për shpërblimit jubilar, ndërsa në bazë të vërtetimit të datës 12.02.2020 të administruar si provë, gjykata vërteton se për periudhën kontestuese 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 paditësja ka shërbyer për 831 ditë pune për të cilat e paditura nuk ia ka paguar shujtën ditore 2 euro në ditë, apo shumën në lartësi 1,662.00€.

- Nga Kontrata e punës me numër 135 e datës 19.02.2001, gjykata ka vërtetuar se paditësi Xh. S., ka përvoja pune mbi 19 vite dhe të njëjtës i takon 50% e një page bazë dhe atë nga paga

bazë në shumën 459.00 euro, paditëse i takon shuma 229.00 euro për shpërblimit jubilar, ndërsa në bazë të vërtetimit të datës 12.02.2020 të administruar si provë, gjykata vërteton se për periudhën kontestuese 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 paditësja ka shërbyer për 892 ditë pune për të cilat e paditura nuk ia ka paguar shujtën ditore 2 euro në ditë, apo shumën në lartësi 1,784.00€.

- Nga Kontrata e punës me numër 246, gjykata ka vërtetuar se paditësja V. H. I., ka përvoja pune mbi 14 vite dhe të njëjtës i takon 50% e një page bazë dhe atë nga paga bazë në shumën 459.00 euro, paditëse i takon shuma 229.00 euro për shpërblimit jubilar, ndërsa në bazë të vërtetimit të datës 12.02.2020 të administruar si provë, gjykata vërteton se për periudhën kontestuese 18.04.2017 e deri më datë 09.09.2021 paditësja ka shërbyer për 892 ditë pune për të cilat e paditura nuk ia ka paguar shujtën ditore 2 euro në ditë, apo shumën në lartësi 1,784.00€.

Baza ligjore-

Lidhur me kërkesën e paditëseve për shpërblimin e pagës jubilarë dhe kompensimin në emër të ushqimit (shujtave ditore), Gjykata e ka trajtuar këtë kërkesë konfrom nenit 90 të Ligjit të Punës lidhur me nenin 35 par. 7 i cili përcakton “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore*”, ndërsa par.8.1.2.3.4.5 të i kësaj Kontrate Sektoriale të Arsimit të Kosovës përcakton se “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë. Pasi që në bazë të shkresave të lëndës dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, konstatohet se paditësit i ka përmbushur kushtet e parapara me këtë Kontratë në tërësi, Gjykata nga këto arsye vendosi si në shumat e gjykuara.*

Në frymën e Nenit 38 të KKSAK-së, me të cilën është përcaktuar se “*Punëdhënësit dhe përfaqësuesit e punëtorëve në sektorin e arsimit (SBASHK) janë të obliguara t’i shmangen çdo veprimi i cili ndikon në pamundësinë e zbatimit e kësaj kontrate.*”, Gjykata vlerëson se e paditura në radhë të parë është në dijeni të numrit të saktë të të punësuarve dhe ka pasur mundësi që të parashikojë shpenzimet përkatëse, dhe / apo t’i drejtohet zyrtarisht Qeverisë së Kosovës / Ministrisë së Arsimit me propozim për alokim të mjeteve shtesë buxhetore, dhe jo me mosveprimin e saj të dëmtojë palët përfituese, në këtë rast paditësit. Prandaj nga sa u tha më lartë, Gjykata vendosi si në pikën I, dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendosjen e lartësisë së kamatës të përcaktuar 8 %, Gjykata vendosi në pajtim me dispozitën e nenit 382 të LMD-së duke e llogaritur atë prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet procedurale-

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur ka për obligim që paditësit t'ia paguaj shpenzimet procedurale dhe atë: në emër të taksës gjyqësore në shumën 20.00€, përfaqësimit në një seancë, shumën 405.00€ për pesë paditës dhe për përpilimin e padisë shumën 312.00€ për pesë paditës si dhe për precizimin e padisë 312€, apo në tërësi shumën 1049.00 euro.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat dhe duke ju referuar neneve 4, 5, 7, 8 dhe 10 lidhur me nenin 143 dhe 146 të Ligjit të Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr.1005/2020, të datës 28.09.2021

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:032233
Datë: 29.09.2021
Numri i dokumentit: 02223699